

KËRKIME GJUHËSORE

Dorjana KLOSI

ÇËSHTJE TË VARIACIONIT GJUHËSOR NË MJEDISIN UNIVERSITAR TË QYTETIT TË VLORËS

Abstrakt. Punimi synon të analizojë dhe të interpretojë në mënyrë sa më të gjerë dhe sa më përfshirëse variacionin gjuhësor që lidhet me mjedisin universitar të qytetit të Vlorës, duke u ndalur në dukuri shumë komplekse, të tilla si ligjërimi dhe sjellja gjuhësore tek studentët, diferencat e sjelljes gjuhësore, të kushtëzuara nga ndryshorët sociolinguistikë e më konkretisht nga ndryshorë të tillë si përkatësia sociale e studentëve, përkatësia gjinore, përkatësia e degës së studimit, etj.

Trajtohen veçoritë e të folurit studentor, me terminologjinë përkatëse që ata përdorin, ndërtimin strukturor të fjalive, në morfologjinë e eptimit, fjalëformimit: përkëdhelitë e sharjet dashamirëse që përdorin studentët e universitetit të Vlorës.

Pjesa më e madhe e gjendjeve të ndryshme gjuhësore është mbledhur nëpërmjet me regjistrimeve me diktofon, anketimeve me pyetësor apo atë spontan. Materiali i mbledhur është analizuar, shqyrtuar, klasifikuar, tipizuar dhe përgjithësuar përmes metodës induktive dhe asaj deduktive.

Fjalët kyç: ligjërim studentor, sjellje gjuhësore, variable sociolinguistikë, sociolekt, idiolekt.

STRUKTURA E KËRKIMIT

1. Hyrje

Metodologjia/mekanizmat e punës

Organizimi i ndërveprimeve

Subjektet

2. Rezultatet

1. Universiteti dhe komunikimi gjuhësor:

- a. Sjellja gjuhësore dhe ligjërimi si pjesë e saj
- b. Ligjërimi studentor

2. Ndryshorët sociolinguistikë:

- a. - diferencat sipas ndryshorit *gjini*
- b. - diferencat sipas ndryshorit *mjedis administrativ*

3. Marrëdhëniet midis:

- a. sociolekt
- b. idiolekt në mjediset universitare të Vlorës

4. Taktikat e ligjëritimit studentor:

- a. Zbunimet dhe përkëdhelitë
- b. Sharjet dashamirëse
- c. Zhargoni studentor vlonjat

5. Kundrime leksiko-semantike dhe gramatikore te ligjërimi studentor në Universitetin e Vlorës

8. Përfundime

Hyrje. Duke qenë afër ligjërimit të studentëve, dhe duke u bazuar në përvojën dhjetë vjeçare në arsim, më lindi ideja për të thelluar njohuritë në fushën e ligjërimit studentor dhe për të evidentuar saktë veçoritë e këtij ligjërimi. Gjithashtu, ligjërimi standard studentor është më i ngulitur në gjuhë dhe ndryshon më pak sesa ligjërimi bisedor dhe ai i shkujdesur, të cilët ndryshojnë shpejt dhe shumë.

Metodologjia/mekanizmat e punës. Pjesa më e madhe e gjendjeve të ndryshme gjuhësore është mbledhur nëpërmjet regjistrimeve me diktofon, anketimeve me pyetësor apo atë spontan.

Organizimi i ndërveprimeve

- **Përzgjedhja e pjesëmarrësve** (pjesëmarrësit u përzgjedhën në bazë të disa kriterëve: mosha, gjinia, statusi social, familjariteti me njëri tjetrin)
- **Mosha dhe statusi social i pjesëmarrësve** (u përzgjedhën pjesëmarrës me moshë të njëjtë)
- **Shoqëria** (pjesëmarrësit në bisedë kishin lidhje shoqërore me njëri-tjetrin)
- **Përmasa e grupit** (bashkëbiseduesit ishin pesë-shtatë persona)
- **Vend i realizimit të bisedës** (auditori, jashtë auditorit (por brenda mjedisit universitar), jashtë mjedisit universitar (shtëpi, lokal, konvikt, etj))
- **Tematika e bashkëveprimit** (Shkolla, familja, shoqëria, përcaktimet gjinore, përkëdhëlitë, sharjet dashamirëse)

Subjektet

Subjekti kryesor i vëzhgimeve, bisedave dhe anketimeve janë studentët e viteve të para, të dyta dhe të treta të Universitetit të Vlorës.

Rezultatet

1. Universiteti dhe komunikimi gjuhësor. Ligjërimi, verbal dhe i shkruar, që përdoret në leksione e seminare në universitet paraqet mënyrat e ndryshme të të shprehurit, të menduarit të studentëve dhe komunikimin që ata zhvillojnë me pedagogët, dhe studentët e tjerë, mbi tematika të caktuara. Gjatë performancës gjuhësore midis subjekteve të lartpërmendur, nxitet dhe shfaqet kompetenca gjuhësore, karakteristikat intelektuale, sociale që kanë studentët, të cilat formësojnë mënyrat se si duhet mësuar e punuar në klasë apo jashtë saj. Në komunikimin gjuhësor që përdoret në klasë duhen shqyrtuar, nga pikëpamja gjuhësore, përgjigjet e studentëve, qartësia e saktësia e shpjegimeve dhe përgjigjeve, etj.

a. Sjellja gjuhësore dhe ligjërimi si pjesë e saj. Stilet dhe situatat ligjërimore ndryshojnë vazhdimisht. Gjuha merr forma dhe përdorime të reja, duke qenë se përdoruesit më krijues e entuziastë janë të rinjtë, ka të ngjarë që identitetet kulturore¹ të kenë lidhje me këtë grupmoshë. Edhe pse, ligjërimi akademik është një ndër tiparet kryesore në institucionet universitare (brenda dhe jashtë klasës), gjuha e studentëve nuk mund t'i shmanget aspektit bisedor dhe deri diku të shkujdesur (jashtë auditorit).

¹ Xh. Lloshi, *Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatika*, Tiranë, 2001 f. 315-319.

ÇËSHTJE TË VARIACIONIT GJUHËSOR NË MJEDISIN UNIVERSITAR TË QYTETIT TË VLORËS

b. Ligjërimi studentor. Studentët përdorin terma të shumtë e të larmishëm në të folurin e përditshëm, sidomos jashtë auditorit. Kjo larmishmëri fjalësh përdoret për të shprehur mendime të ndryshme apo për të përshkruar e interpretuar ngjarje e situata në të cilat ata marrin pjesë. Pikërisht në këto situata, që klasifikohen në këtë punim, studentët e degëve të ndryshme përdorin stil dhe leksik të ngjashëm të të shprehurit dhe të komunikuarit, përse u përket ngjyrimëve që ata u japin termave e bisedave rreth mësimit apo eksperiencave të përditshme.

Gjithashtu, nga studimi u vu re se ligjërimi standard studentor është më i ngulitur në gjuhë dhe ndryshon më pak sesa ligjërimi bisedor dhe ai i shkujdesur, të cilët ndryshojnë shpejt dhe shumë.

2. Ndryshorët sociolinguistikë

a. Diferencat sipas ndryshorit gjini. Ndryshimet në të folurin gjinor rrjedhin nga koncepti që vajzat dhe djemtë kanë për komunikimin. Përse shërben komunikimi?² - është pyetja që femrat dhe meshkujt i japin përgjigje të ndryshme. Më poshtë jepen disa tipare të përgjithshme që karakterizojnë ligjërimet gjinore.

Ligjërimi femëror është më i kujdesshëm në formulimin e frazave; ndonjëherë është hezitues dhe emocional, pra karakterizohet nga një gjuhë që shpreh pasiguri.

- Vajzat flasin më shumë se djemtë, janë më të sjellshme, ankohen më shumë, dhe janë më bashkëpunuese.
- Bëjnë më shumë pyetje sesa djemtë. Ligjërimi i tyre karakterizohet më tepër nga pyetja “PSE?”
- I shpjegojnë dhe modifikojnë thëniet e tyre, duke përdorur fjalë si: domethënë, kështu pra, etj.
- Përdorin shprehje tepër të zbukuruara, por edhe fjali ku shprehet mosbesim.
- Përdorin më shumë përemra, folje dhe fjalë sociale, fjalë që përshkruajnë gjendje të ndryshme emocionale dhe psikologjike. Mohimi dhe fjalët referuese për shtëpinë, janë gjithashtu tipare të këtij ligjërimi.

Ligjërimi mashkullor

- Gjuha që ata përdorin është e prerë, koncize dhe karakterizohet nga ton deklarativ;
- Ligjërimi i tyre është direkt, që shpreh fuqi dhe siguri dhe flasin me më shumë autoritet.
- Shprehjet e përdorura prej tyre janë më të shkurtra, ku ndonjëherë dëgjohen fjalë të ligjërimin të shkujdesur.
- Diskutojnë më tepër për çështje që janë shqetësuese për ata dhe betohen më shpesh. Frekuenca e përdorimit të këtyre fjalëve ka lidhje me temën e bisedës.

² J. Maxwell, and J. Heritage, *Structures of Social Action: Studies in Conversation Analysis*, Cambridge, 1984.

DORJANA KLOSI

• Ata flasim më shumë për sportin, vajzat dhe makinat në të njëjtën mënyrë nuk flasin për ndjenjat, fyejnë shpesh njëri-tjetrin, janë konkurruese në bisedë, dominojnë bisedën, japin më shumë komanda, ndërpresin më shumë në bisedë.

Të dyja gjinitë përdorin të njëjtat burime gjuhësore dhe shfrytëzojnë të njëjtin sistem komunikimi. Kështu që, gjatë përdorimit të gjuhës në bisedë midis gjinive, disa elementë mbivendosen me njëri-tjetrin dhe si rezultat, ligjërimi femëror dhe mashkullor, përveç ndryshimeve të shumta, shfaq edhe elementë të ngjashëm³.

Megjithatë, duhet pasur parasysh se diferencat gjuhësore midis gjinive nuk nxiten nga elementë gjuhësor, por këto ndryshime janë produkt i proceseve dhe praktikave sociale. Të qënurit djalë apo vajzë *ndërtohet* nga shoqëria⁴ - një proces gjatë të cilit gjuha luan rol kyç.

b. Diferencat sipas ndryshorit mjedis administrativ. Mjedisi shoqëror, vendlindja dhe kontakti i vazhdueshëm i këtyre elementëve, ndikon dukshëm në të folurin individual. Të rinjtë studentë, tashmë, e zotërojnë mirë kompetencën e tyre gjuhësore, dhe kur përballen me folës të qyteteve të ndryshme e kanë të lehtë të përcaktojnë origjinën dhe kulturën e interlokutorëve.

Kjo situatë gjuhësore paraqitet edhe në Universitetin e Vlorës. Shumë prej studentëve, vendas ose të qyteteve të tjera, bëjnë përpjekje për të folur në gjuhën standarde. Megjithatë, janë jo të pakta situatat, tematikat në të cilat ata përdorin tipare ligjërimore të mjedisit administrativ e familjar të tyre. Në tabelën #1 paraqiten disa nga fjalët dhe shprehjet që studentë nga qytete të ndryshme përdorin në situata të caktuara, deri diku me humor, dhe me shoqërinë e tyre të ngushtë, p.sh.:

Tabela #1

Qyteti	Shprehje tipike të vendlindjes	Shprehje tipike të mjedisit familjar
Vlorë	<i>Vehi</i> (vendi), <i>krypë</i> (kripë), e bëra.	
Durrës	<i>O me ça bone? Do ikim për qokë. Kemi lujt menç! Mananej...! Je tu u ngrof n'diell! Jamallnume...!</i> (Jam zemëruar)	<i>Shëndet, jetë dhe harmoni i kërkoh Zotit!, Kështu u mbleshim përhera!, "Mizerje!"</i> (me përkëdheli)
Berat	Kokudha	
Lushnjë	<i>Qysh?</i> (si?), <i>imën</i> (tani), <i>akshëm</i> (mbasdite)	

Në tabelën #2 paraqiten disa nga fjalët e shprehjet që studentët nuk i përdorin në mjediset universitare ose me studentë që nuk janë të rrethit të tyre të

³ K. Blumstein, and P .Schwartz, *Sex and Power in Interaction* American Sociological, 1985, f. 23-28.

⁴ J. Simkins Bullock, and B. Wildman, *An Investigation into the Relationships Between Gender and Language' Sex Roles*, Washington, 1991, f. 56-124.

ÇËSHTJE TË VARIACIONIT GJUHËSOR NË MJEDISIN UNIVERSITAR TË
QYTETIT TË VLORËS

ngushtë shoqëror dhe në këtë mënyrë të shmangin keqkuptimet e ndryshme kulturore, gjuhësore apo etiketimet që janë rezultat i përdorimit të gjuhës së vendlindjes⁵.

Tabela #2

Qyteti	Shprehje tipike të vendlindjes	Shprehje tipike të mjedisit familjar
Vlorë	<i>aderbardhë</i> (të kesh “derën-fatim” e bardhë), <i>sabah</i> (mëngjes), <i>xhade</i> (rrugë), <i>avlli</i> , <i>derman</i> , <i>t’u bëfsha</i> , <i>hë të keqen</i> , <i>hiç pa bili</i> . (hiç po Abili)	Proverbat ose fjalët e urta, shprehjet tipike të krahinës së tyre
Durrës	<i>O me ça bone? Do ikim për qokë. Kemi lujt menç! Mananej....! Je tu u ngrof n’diell! Jamallnume...!</i>	
Berat	<i>Hëmë, hëime, e re</i> (hë ore)	
Lushnjë	<i>Qysh?</i> (si?), <i>imën</i> (tani)	
Çorovodë	<i>Çyryke, qerrata, babaxhan</i>	

3. Marrëdhëniet midis sociolekt / idiolekt në mjediset universitare të

Vlorës

a. Sociolekt. Shpesh, grupmoshat e reja kanë "gjuhën" e tyre, i njohur me përkufizimin lingvistik: variacion i ligjëratës i përdorur nga një grup i caktuar. Bisedat dhe pyetësorët e zhvilluar me studentë të grupeve të ndryshme shoqërore, evidentuan disa nga arsyet e variacionit gjuhësor për shkak të grupmoshës së njëjtë⁶:

- (1) të rrisin identitetin e tyre kulturor
- (2) të identifikohen me njëri-tjetrin
- (3) të përjashtojnë të tjerët nga grupi i tyre
- (4) të largojnë ndjenjat e frikës nga bota e jashtme.

Sociolekti i grupeve të ndryshme shoqërore dallohen nga njëri-tjetri nga përdorimi i fjalëve, shprehjeve dhe strukturave gramatikore të cilat nuk i përkasin shqipes standarde.

Tabela #3

	Fjalë	Shprehje	Fjali
Grupi I	Kamiato; BMW portokalli; varja; mendje e ligë;	Atë e di unë; palaço njeri; atë e di unë!; hajde nesër;	Ik vrit veten!; leje fare; unë jo se s’dua, po s’mundem;
Grupi II	Dak dak; bukuleshk; amigo;	Sha bone, sha bone; hë la, më	Bën sikur ke çliruar Shqipërinë!;

⁵ E. Huls, Family Interaction from an Interactional Sociolinguistic Perspective, 1988, f. 98-123.

⁶ Lloshi, Xhevat “Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatika ” Shtëpia botuese e Librit Universitar, Tiranë, 2001 ISBN 99927-0-145-5.

DORJANA KLOSI

	kosmirënjuhëse; portokaqielli;	thuj;	
Grupi III	Interestorante; Miza; uç- uç; shdukusu; e zeleçme;	je legen (dashmirëse);	T'a bën borxh ai/ajo; U prish dynjaja fare;

b. Idiolekt. Secili prej nesh i përket grupeve të ndryshme sociale, dhe gjithsecili përdor shumëllojshmëri stilesh gjuhësore⁷, me elementë që janë paksa të ndryshëm nga stilet gjuhësorë të përdoruesve të tjerë të gjuhës. Ndryshimet më të shumta në nivel individual, janë hasur në *fjalorin* e përdorur sipas interesave dhe aktiviteteve dhe *shqiptimin* e fjalëve e shprehjeve të ndryshme, i cili ndikohet nga mjedisi administrativ që vjen secili student. Elementët e lartpërmendur ndryshojnë dhe përshtaten sipas interlokutorit me të cilin zhvillohet biseda. Disa prej fjalëve dhe shprehjeve me kuptime metaforike të studentëve të ndryshëm, paraqiten në

Tabelën #4.

Qyteti	Shprehje tipike të vendlindjes
Studenti 1	Çupa; zemra; yllo; botrore; omg (oh my God!—ndikimi nga Facebook)
Studenti 2	Daku; zogu; s'nuk fare; mizerje.
Studenti 3	Budallai; çapaçule; robi.
Studenti 4	Top bore; majmune; fresk fare.

4. Taktikat e ligjërimit studentor

a. Zbunimet dhe përkëdhelitë. Të shumta janë fjalët dhe shprehjet zbutuese ose përkëdhelëse që studentët përdorin me njëri-tjetrin, në mjediset universitare por edhe jashtë tyre. Vajzat dhe djemtë kanë fjalorin e tyre në lidhje me gjininë e njëjtë ose të kundërt⁸. Më poshtë jepen, disa shembuj që vajzat studente të degës së gjuhë-letërsisë përdorin gjatë bisedave shoqërore me shokët e shoqet e tyre, brenda dhe jashtë mjedisit universitar.

Tabela #5

	Në mjediset e universitetit (jashtë auditorit)		Mjediset jashtë universitetit	
	Për vajzat	Për djemtë	Për vajzat	Për djemtë
Etiketime të ndryshme	Milingona, arush polar, zogu, arushe, lepurushe, miza		Sorrë, laraskë,	
Kategoria e "embëlsirave"				Rrusha, akullore,

⁷ Ferguson, N (1977) 'Simultaneous Speech, Interruptions and Dominance' British Journal of Social and Clinical Psychology 16: 295-302.

⁸ Gjovalin Shkurtaj *Pesha e fjalës shqipe* Shtëpia Botuese: UFO ISBN: 978-99956-19-44.

ÇËSHTJE TË VARIACIONIT GJUHËSOR NË MJEDISIN UNIVERSITAR TË QYTETIT TË VLORËS

				çokollatë
Etiketime “pozitive”	Yll, zonjushë, mësonjëse	Fenomeni, king, student i dashur, o shoku student, vllai	Zemër, yll, kokolusha,	sybukri, bukuroshi, ai tipi,
Etiketime “negative”	Xhevie, grifshë, guapa,	mostër	shtrigë, zogu	
Shtrembërimet e fjalëve	Zembra, shtëpirti, çoçe			
Fjalët e huaja			Hani (Honey)	Suiti (sweety)
Shtrembërimet e emrit, nofka emrash	PJESERISHT	PJESERISHT	PO	PO

b. Sharjet dashamirëse. Ligjërimi studentor është mjaft i pasur edhe me element figurative, të cilat kategorizohen si “sharje dashamirëse”⁹. Disa prej elementëve dhe shembujve që u hasën në kategorinë e lartpërmendur, gjenden edhe në këtë nën-ndarje:

Tabela #6

	Në mjediset e universitetit (jashtë auditorit)		Mjediset jashtë universitetit	
	Për vajzat	Për djemtë	Për vajzat	Për djemtë
Etiketime të ndryshme	Kafshë, majmune, dhia, pilivesa	dele rudë		Buf
Etiketime në lidhje me karakterin ose veprimin	Shtrigë, mizerje, hajdute, kopjace, e poshtë	Fshatar, mizerje, i poshtë, sorollatës	Mavri, shushudake, Ema Bovari, “Menekshe”	Don zhuan
Etiketime në lidhje me zgjuarsinë	budallaqe, daune, shushkë, je me probleme,	budalla	Idiote	legena, idiot,
Etiketime në lidhje me paraqitjen e jashtme	Shëmtira	Mostër	Pipiricka, zhulse,	Zhuls,
Shtrembërimet e emrit,	PJESERISHT	PJESERISHT	PO	PO

⁹ Gj. Shkurtaç, *Pesha e fjalës shqipe*, Tiranë, 2004, f. 166.

nofka emrash			
--------------	--	--	--

c. Zhargoni studentor vlonjat. Të rinjtë e universiteteve kanë pasur dhe kanë disa tipare ligjërimore të tyre, që janë emërtuar si një lloj i veçantë i të folurit apo si “zhargoni studentor”. Ky lloj të foluri synon të krijojë një “kod” të posaçëm¹⁰ shprehjeje midis anëtarëve të rrethit studentor. Disa prej tipareve të përgjithshme të “zhargonit studentor” janë:

- Metaforat që studentët përdorin për të etiketuar ose ironizuar profilet apo fakultetet e njëri- tjetrit, si p.sh.: *përkthyesit, evropianë, angleze, pipino* (për gjuhët e huaja), *doktorët* (për infermierinë), *shkencëtarët, fizikantët, anjshantjët* (për studentët e fizikës), *cerdhja, kopshti, mësuskat* (për studentët e pedagogjisë), *biologët, mikroskopistat* (për biologjinë), *të shifruarit, llogaritarët, biznesmena* (për biznesin), *peshkatarët* (për inxhinierinë navale), *oratorët, pedagogët e ardhshëm, llafollogët* (për gjuhë-letërsinë), *avokatët, kokë shteti, mëndjemëdhenjtë* (student i juridikut).
- Po ashtu, në mënyrë figurative studentët shprehen edhe për notat, provimet, etj., si p.sh.: *po ky leksioni kinez që nuk mësohej fare...* (leksion i vështirë për t’u kuptuar), *erdhën sërisht prapë mandatat* (filloi sezoni i provimeve), *na janë bërë këto mësimet si burri i nënës, mësimet dhe vetëm mësimet* (për të shprehur lodhjen nga mësimet).
- Të shumta janë edhe shprehjet që përmbajnë terma specifike të profileve të ndryshme të studimit, si p.sh.: *kontekst, koncept, tip Homerik* (për dikë që i pëlqen poezitë ose krijon poezi), *je si pikëpyetje* (jo e bukur), *bën si Naimi, sot i ezauruam të gjitha* (nuk kemi më për çfarë të flasim), *kujdes reticencën* (fol mirë), *gjuhëtar analfabet* (i paditur), *zanore e hapur* (e shëndoshë), *variant i lirë* (beqar).
- Në ligjërimin studentor shpesh përdoren edhe figura letrare me ngjyrimet negative për studentët konviktore, si p.sh.: për vajzat konviktoresh: *kokëpalara, bredharake, pularia, shushkë, të shëmtuarat, katundaret, piset*. Për djemtë: *fshatarë, lumadhi, pabuksat, ordiner, barkëtharët, jabanxhi, barbona, emigrantë*.

5. Kundrime leksiko-semantike dhe gramatikore te ligjërimi studentor në Universitetin e Vlorës

a. Kundrime leksiko-semantike. Më poshtë paraqiten disa prej karakteristikave të ligjërimin bisedor midis studentëve, jashtë auditorit¹¹.

- Përdorimi i fjalëve në mënyrë të figurshme, p.sh.: *Ky s’ka për të na kaluar* (për të marrë notë pozitive); *Mezi po pres të vi vera, të vemi në plazh, që të na freskohet mendja nga kjo shkolla* (qetësohemi);
- Përdorimi i krahasimeve në fjali, p.sh.: *Ne jemi (si) fenomena*.

¹⁰ Gj. Shkurtaç, *Sociolinguistika*, Tiranë, 2005, f. 264-298.

¹¹ E. Ochs, *Transcription as Theory*, The Discourse Reader' Routledge, 1999, f. 15-18.

ÇËSHTJE TË VARIACIONIT GJUHËSOR NË MJEDISIN UNIVERSITAR TË QYTETIT TË VLORËS

- Përdorimi i fjalëve që theksojnë anën emocionale, p.sh.: **Bombë fare!**; **Grand pushime!** O Zot, hajde merru me këto **drej_provimesh!** **Aleluja!** *Më në fund relaks dhe plazh!*
- Përdorimi i fjalëve dhe shprehjeve që përdoren në rrjete të ndryshme sociale, p.sh.: *frendsa*; *omg* (O my God!—Zot i madh!); *ma nis në inboks* (inbox);
- Përdorimi i fjalëve të huaja, sidomos, huazimet nga gjuha angleze/italiane, p.sh.: *neiborhutsa*; *kull* (*cool--fantastik*); *grand*; *super*; *kis-kis* (kiss-kiss--puthje);

b. Kundrime gramatikore

- Përdorimi i fjalive pa kryefjalë, p.sh.: *(Unë) nuk isha në klasë dhe ngela mbrapa*; *(Leksionet) janë të vështira, të pakuptueshme*.
- Fjalja paraqitet me renditje të ndryshme të gjymtyrëve, p.sh.: *I kemi lënë pas shumë tema* (Shumë tema i kemi lënë pas); *Ishte një verë super* (Vera ishte super).
- Mungesa e foljes në fjali, p.sh.: *(Ne)+(kemi)+tre provime në një ditë; I vështirë +(ishte)+ provimi*.
- Përdorimi i trajtave të shkurtuara, p.sh.: *S'di si do dal në provim; Na i kishte ngrënë disa pikë*.

6. Diskutime

Nga studimi mbi element të ndryshëm të ligjërimit studentor, arrihet në konkluzionin se zhargoni i përgjithshëm studentor, sociolekti, idiolekti, karakteristikat e ligjërimit sipas gjinisë e mjedisit administrativ, zbulimi, përkëdhelitë dhe “sharjet dashmirëse” zënë vend të veçantë në ligjërimit verbal të studentëve, duke i dhënë karakter bisedor komunikimit jashtë auditorit. Këto elemente janë dukuri me karakter gjuhësor e shoqëror dhe zbatohen në rrethana që burojnë nga strategjia e ligjërimit. Ato ndjekin parimin e njohur: “*Kush flet, me kë, ku, kur, për çfarë dhe në cilin varietet*”.

Një përqindje e madhe e studentëve të anketuar, kanë pranuar gjatë bisedave me miqtë e tyre të ngushtë, brenda (jo në klasë) dhe jashtë mjediseve universitare, ata përdorin shumë fjalë e shprehje të cilat shërbejnë si tregues të anëtarësisë së tyre shoqërore, duke nisur nga universiteti, si komuniteti më i madh i shoqëror i studentëve, tek grupet shoqërore të studentëve në bazë fakulteti e departamenti, deri tek grupet e vogla sociale që krijohen midis studentëve të degëve të ndryshme ose grupet me bazë gjinore. Të gjitha shprehjet individuale ose të grupit shoqëror, zbulimet dhe sharjet dashmirëse ndaj anëtarëve të grupit social përdoren për të shprehur afrimet, dashuri, apo për humor, etj.